



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. l.faq Broj. stranica Nr. pages	02
Nr. Prot Br Prot Prot No	03-02/159/18
Data Datum Date	18-01-2018
Pë. SHITISE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.01.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3729-17, për Zyrtarin e lartë z.Durim Krasniqi-Zyrtar kryesor financiar në N.P. "Trainkos", për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-3729/17, për Zyrtarin e lartë, z.Durim Krasniqi-Zyrtar kryesor financiar në N.P. "Trainkos", dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Durim Krasniqi (Dpk-03-02-3844/17), dhe pastaj ai është kontaktuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, me ç'rast në bisedë zyrtare është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Krasniqi është deklaruar se brenda afatit të caktuar nga Agjencia, do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë, z.Krasniqi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet mbi ndryshimet në biznes; N.N."ABM-TIKI" (DPK-03-02-3994/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Krasniqi tashmë ka hequr dorë nga



funksionet menaxhuese në bizneset private, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

  
/ Shqip Havolli

